

## **NJOFTIM PËR SHTYP**

Në kuadër të projektit “Jean Monnet Center of Excellence South and East European Competition Law”, projekt i cili përfshin akademikë dhe ekspertë të së drejtës së konkurrencës nga vende të ndryshme të Evropës dhe ballkanit perëndimor, u zhvillua më datë 1 qershor tryeza e rumbullakët me temë “Fuqizimi i zbatimit të së drejtës së konkurrencës dhe avokimi i saj”.

Në këtë aktivitet i cili kishte si synim promovimin e kulturës së konkurrencës, mbrojtjes së konkurrencës së lire, efektive dhe mirëfunksionimit të tregut, ishte i ftuar Z. Denar Biba, Kryetar i Autoritetit të Konkurrencës.

Në fjalën e tij, Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës Z. Biba prezantoi për të pranishmit, specifikat kryesore të legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës, funksionimin e AK në kontrollin, zbulimin dhe ndëshkimin në rast të shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Gjithashtu gjatë prezantimit, të pranishmëve ju ilustruan raste konkrete nga veprimtaria e Autoritetit lidhur me hetime të mëparëshme dhe sfidat me të cilat përballet ky instiucion në punën e përditshme.

Ky aktivitet u organizua për herë të parë Shqipëri pasi ishte zhvilluar edhe në Itali dhe Serbi. Pjesëmarrësit e për zgjedhur me kujdes nga ana e Organizatorëve ishin ekspertë të njohur të së drejtës së konkurrencës nga vende të tjera si: Kroacia, Italia, Serbia, Bosnje Hercegovina etj.

Autoriteti i Konkurrencës do të vijojë të marrë pjesë në aktivitete të kësaj natyre me qëllim promovimin dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë